

**Kompania Regjionale e MbeturinaVe (KRM) “ÇABRATI” SH.A.**

**PASQYRAT FINANCIARE**

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

**Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017**

**Përmbajtja:**

Raporti i auditorit të pavarur	<b>3</b>
Pasqyra e pozicionit financiar	<b>5</b>
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	<b>6</b>
Pasqyra e rrjedhës së parasë	<b>7</b>
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	<b>8</b>
Shënimet e pasqyrave financiare	<b>9</b>

## **RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR**

Për: Bordin e drejtorëve të KRM “ÇABRATT” SH.A.

### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KRM “ÇABRATT” SH.A. të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2017 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitive financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2017 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza për opinion**

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

### **Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijoje sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomali mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të

grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.

Në gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rrezeqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përfutur e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi afërsinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfutur deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfarido mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuara gjatë auditimit tonë.

24 Prill 2018

Lulzim Zeka  
Auditor ligjor



**BAKER TILLY**  
KOSOVO  
Prishtinë

Baker Tilly Kosovo

**KRM “ÇABRATI” SH.A.**  
**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
**Më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**  
(të gjitha shumat janë në Euro)

	Shënim	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
<b>Pasuria</b>			
<b>Pasuria afatgjatë</b>			
Prona, impiantet dhe paisjet	4	2,168,461	2,213,158
<b>Gjithsej pasuria afatgjatë</b>		<b>2,168,461</b>	<b>2,213,158</b>
<b>Pasuria afatshkurtër</b>			
Llogaritë e arkëtueshme	5	227,467	258,566
Parapagimet	6	11,714	12,355
Llogaritë e arketueshme - Qytetaret & Bizneset	7	646,464	598,380
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	47,743	26,868
<b>Gjithsej pasuria afatshkurtër</b>		<b>933,388</b>	<b>896,169</b>
<b>Gjithsej pasuria</b>		<b>3,101,849</b>	<b>3,109,327</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali aksionar</b>			
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar		2,342,627	2,342,627
Fitimet/ (humbjet) e bartura		576,696	534,723
Fitimet/(humbjet) e vitit		90,580	41,973
<b>Gjithsej kapitali aksionar</b>		<b>3,009,903</b>	<b>2,919,323</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huamarrjet- pjesa afatgjatë		-	-
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Detyrimet afatshkurta</b>			
Llogarite e pagueshme tregtare	9	30,472	73,105
Obligimet per paga, tatime dhe kontribute	10	51,368	80,930
Obligimet per tatimin ne fitim	11	7,274	17,817
TVSH e pagueshme	12	2,833	18,151
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurta</b>		<b>91,946</b>	<b>190,004</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar</b>		<b>3,101,849</b>	<b>3,109,327</b>

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe nënshkruar me 29 mars 2018 nga:

**Kujtim Qela**

Drejtor financiar, (U.D. Kryeshef Ekzekutiv)

KRM “ÇABRATI” SH.A.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFISHRËSE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumatat janë në Euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	Shënim	2017	2016
Te hyrat nga shërbimet	12	973,123	994,219
<b>Total të hyrat</b>		<b>973,123</b>	<b>994,219</b>
Shpenzimet e materialit	13	(112,266)	(109,228)
Shpenzimet e pagave	14	(571,894)	(512,902)
Shpenzimet e zhvleresimit	15	(44,430)	(59,565)
Shpenzimet tjera	16	(116,969)	(173,077)
Shpenzimet tjera afariste	17	(33,044)	(22,615)
Shpenzimet e borxheve të keqja	18	(16,901)	(74,037)
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>(895,504)</b>	<b>(951,423)</b>
Të hyrat tjera të jashtëzakonshme	19	20,235	-
<b>Fitimi para tatimit në fitim</b>		<b>97,854</b>	<b>42,796</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	20	(7,274)	(823)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>90,581</b>	<b>41,973</b>

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe nënshkruar me 29 mars 2018 nga:

**Kujtim Qela**

Drejtor financiar (U.D. Kryeshef Ekzekutiv)

---

**KRM “ÇABRATI” SH.A.**  
**PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË**  
**Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**  
(të gjitha shumat janë në Euro)

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<b>I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi (humbja) e vitit	97,854	41,973
Të korrigjuara për:		
Zhvlerësimi	44,430	59,565
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	(16,345)	11,466
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	(105,065)	(90,867)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>(76,979)</b>	<b>(19,836)</b>
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)</b>	<b>20,875</b>	<b>22,137</b>
<b>II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	-	(7,144)
Investimet tjera në pronë, impiante dhe pajisje		
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)</b>	<b>-</b>	<b>(7,144)</b>
<b>III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Kredi bankare	-	
Tërheqjet e fitimit	-	
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)</b>	<b>20,875</b>	<b>14,993</b>
<b>V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës</b>	<b>26,868</b>	<b>11,875</b>
<b>VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës (IV + V)</b>	<b>47,743</b>	<b>26,868</b>

**KRM “ÇABRATI” SH.A.**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**  
**Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**  
(të gjitha shumat janë në Euro)

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
<b>Ekuiteti</b>		
Kapitali i pronarit	471,472	471,472
Fitimet ose Humbjet e bartura	576,696	534,723
Fitimi/Humbja e vitit	97,854	41,973
Rezervat e Rivlerësimit	1,871,154	1,881,154
<b>Gjithsej Ekuiteti</b>	<b>3,017,177</b>	<b>2,929,323</b>



## KRM “ÇABRATI” SH.A.

### SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### 1. INFORMATAT E PËRGJITHSHME

##### Organizata

Kompania Regjionale e Mbeturinave “Çabrati” SH.A Gjakovë është shoqëri aksionare e themeluar me 01.02.2008, themelues i së cilës është Komuna e Gjakovës. Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25 mijë Euro. Kompania furnizohet me shërbimet e poshtshënuara në qytetin e Gjakovës dhe fshatrat e kësaj komune. Kompania është regjistruar me datë 28.12.2007 me Numër të biznesit: 70465138 dhe Numër fiskal: 600303896.

Kompania gjatë vitit që përfundoi me 31 dhjetor 2017 mesatarisht ka punësuar 125 punonjës (mesatarisht 125 punonjës për vitin 2016).

Veprimtaria kryesore e Kompanisë është pastrimi dhe evitimi ujërave ndotëse, trajtimi i hedhurinave, veprimtaritë sanitare dhe të ngjashme.

#### 1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

##### 2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë shprehur në Euro. Aty ku ka qenë e nevojshme, të dhënat krahasuese janë harmonizuar për t'u përshtatur me ndryshimet në prezantimin për vitin.

##### 2.2 Valuta funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë prezantuar në Euro, e cila është valutë funksionale e kompanisë.

##### 2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF kërkon nga menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve.

##### 2.4 Hipoteza e vijimësisë

Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë përgatitur mbi bazën e hipotezës së vijimësisë, e cila supozon që Kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë dhe të paguajë detyrimet e saj gjatë operimit normal të biznesit.

##### 2.5 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosje

Organizata ka zbatuar, për herë të parë, disa standarde dhe ndryshime në standard, të cilat janë efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 janar 2017. Organizata nuk ka adoptuar ndonjë standard tjetër, interpretim ose ndryshim që është lëshuar por që nuk ka hyrë në fuqi. Disa prej ndryshimeve të zbatohen për herë të parë në vitin 2017. Mirëpo nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Organizatës prandaj nuk janë shpalosur. Natyra dhe efekti i këtyre ndryshimeve janë shpalosur më poshtë. Edhe pse këto standarde dhe ndryshime të reja zbatohen për herë të parë në vitin 2016, ato nuk kanë ndikim material në pasqyrat financiare të Organizatës.

## KRM "ÇABRATI" SH.A.

### SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### 2.6 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

#### 2.7 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

#### 2.8 Prona dhe pajisjet

##### (i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përshinë shpenzime që i atribuohen direkt blerjes së aktivitetit afatgjatë material. Kostoja e aktiveve afatgjata materiale të vetë-ndërtuara përfshinë koston e materialeve dhe të punës direkte, dhe çfarëdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit afatgjatë material në gjendjen funksionale për funksionimin e tij. Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponente kryesore) të aktiveve afatgjata.

##### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhme që i atribuohen atij elementi do t'i përkasin Kompanisë, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

##### (iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme të aktiveve. Zhvlerësimi kalkulohet duke përdorur metodën lineare. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) rivlerësohen në datën e raportimit

Prona dhe pajisjet zhvlerësohen sipas metodës lineare me normat në vijim:

- |                           |     |
|---------------------------|-----|
| • Objektet ndërtimore     | 16% |
| • Makinaria dhe pajisjet  | 16% |
| • Pajisje dhe mobile zyre | 16% |

#### 2.9 Stoqet

Stoqet maten me shumën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe realizimin e shitjes

## KRM "ÇABRATI" SH.A.

### SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### 2.10 Instrumentet financiare

Kompania mban vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, hua, dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, për instrumentet që nuk janë të shprehura në vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Pas njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative vlerësohen si më poshtë.

Një instrument financiar njihet në rast se Kompania bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Kompanisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Kompania i transferon aktivin financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, pra datën në të cilën Kompania zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Kompanisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

##### *Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra likuide me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një risku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Kompania në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj vlerësohen me koston e amortizuar.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuar me humbjet nga rënia në vlerë.

##### *Llogari të pagueshme dhe tjera*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

#### 2.11 Përfitimet e punonjësve

##### *Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore*

Kompania paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur arrijnë moshën për pension. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Kompanisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

##### *Leje vjetore të paguara*

Kompania njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuar në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

#### 2.12 Shpenzimet

##### *Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

## **KRM “ÇABRATI” SH.A.**

### **SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

**Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### **2.13 Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimit në bilanc, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur bazuar në metodën e realizimit ose kompensimit të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

#### **2.14 Tatim fitimi**

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit aktivi të mund të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

#### **2.15 Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Vlera e drejtë e mjeteve monetare, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël neto, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

### **3. Zbatimi i Standardeve Ndërkombatëre të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të ndryshuara**

#### **Ndryshimet në SNRF që janë të obligueshme dhe efektive për vitin aktual**

Në vitin aktual, Kompania ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme për periudhat kontabël që fillojnë me ose pas 1 janar 2017.

#### **Ndryshimet në SNK 7 Iniciativa e Shpalosjeve**

Kompania ka zbatuar ndryshimet për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet kërkojnë që entiteti të ofrojë shpalosje për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet nga aktivitetet financiare, përfshirë ndryshimet me para dhe jo para.

Detyrimet e Kompanisë që rrejdhin nga aktivitetet financiare përbëhen nga huamarrjet (shënimi 8). Harmonizimi në mes të gjendjes fillestare dhe përfundimtare është paraqitur në shënimin 8.1. Në pajtueshmëri me dispozitat kalimtare të ndryshimeve në standard, Kompania nuk ka shpalosur informatat krahasuese për periudhën e mëparshme. Përveç shpalosjeve shtesë në shënimin 8.1, zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

## KRM “ÇABRATI” SH.A.

### SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### **Ndryshimet në SNK 12 Njohja e Pasurive të Tatimit të Shtyrë për Humbjet e Perealizuara**

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet qartësojnë se si entiteti duhet të vlerësoj nëse do të ketë fitime të mjaftueshme të tatueshme në të ardhmen kundrejt të cilave mund të përdor diferencat e përkohshme të zbritshme.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë pasi që kompania tashmë ka vlerësuar mjaftueshmërinë e fitimeve të ardhshme të tatueshme në atë mënyrë që të jetë në konsistencë me këto ndryshime.

#### **Përmirësimet vjetorë të SNRF – cikli 2014-2016**

Kompania ka zbatuar ndryshimet në SNRF 12 të përfshira në ciklin e përmirësimeve vjetore 2014-2016 për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet tjera të përfshira në këtë pako nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar më herët nga Kompania.

SNRF 12 thekson se një entitet nuk duhet të ofrojë informata të përmbledhura financiare për interesat në filiale, investime në shoqëri ose ndërmarrje të përbashkëta të cilat janë klasifikuar (ose përfshirë në grupin për tu shitur që është klasifikuar) si të mbajtura për shitje. Ndryshimet qartësojnë se ky është përjashtimi i vetëm nga kërkesat për shpalosje të SNRF 12 për këto interesa.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë pasi që asnjë nga interesat në këto entitete nuk është klasifikuar ose përfshirë në grupin për shitje i cili është klasifikuar si i mbajtur për shitje.

#### **Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese të cilat nuk janë ende efektive**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese janë publikuar nga BSNK të cilat nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar nga Kompania. Informatat për ndryshimet që pritet të jenë relevante për Kompaninë, janë paraqitur më poshtë.

Menaxhmenti pret se të gjitha publikimet do të adoptohen në politikat kontabël të Kompanisë për periudhën e parë që fillon pas datës efektive të publikimeve. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë adoptuar ose nuk janë listuar më poshtë nuk pritet të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

#### **SNRF 9 Instrumentet financiare**

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime domethënëse në udhëzimet e SNK 39 për riklasifikimin dhe matjen e pasurive financiare dhe paraqet modelin e ri të ‘humbjes së pritur kreditorë’ për dëmtimin e pasurive financiare. SNRF 9 po ashtu ofron ushëzime të reja mbi zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Menaxhmenti ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9 por nuk është ende në pozitë të ofrojnë informata të kuantifikuara.

SNRF 9 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

#### **SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët**

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të hyrave, duke zëvendësuar SNK 18 “Të hyrat”, SNK 11 ‘Kontratat ndërtimore’ dhe disa interpretime që lidhen me të hyrat. Parimi themelor i SNRF 15 është që entiteti duhet të njoh të hyrat ashtu që ilustron transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara te konsumatorët në shumën që reflekton konsideratën për të cilën entiteti ka të drejtën si shkëmbim për ato mallra ose shërbime.

SNRF 15 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

## **KRM “ÇABRATI” SH.A.**

### **SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

**Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### **SNRF 16 Lizingu**

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënësit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jasht bilancit) dhe lizingut financiar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përveç për lizingjet afatshkurta dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

SNRF është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofroj informata të kuantifikuara.

## KRM "ÇABRATI" SH.A.

### SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

### 3. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

#### 3.1 Faktorët e riskut financiar

Aktivitetet e kompanisë ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare, përfshirë riskun e kredisë dhe riskun e shoqëruar me efektet e ndryshimeve në kurset e huaja të shkëmbimit dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të organizatës fokusohet në pa-parashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën afariste të kompanisë.

#### 3.2 Rreziku Kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të kompanisë nëse klienti ose pala tjetër e instrumentit financiar dështon t'i kryejë obligimet e saja kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga të arkëtueshmet tregtare të kompanisë, depozitat në banka, dhe parat e gatshme dhe ekuivalentët e saj.

Në fund të vitit kompania nuk kishte asnjë ekspozim në vendet e huaja, pasi që të gjitha parat janë mbajtur në llogaritë e bankave komerciale në Kosovë.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<i>Klasat e pasurive financiare-vlera kontabël:</i>		
Llogaritë e arkëtueshme	227,467	258,566
Parapagimet	11,714	12,355
Llogaritë e arkëtueshme - Qytetaret & Bizneset	646,464	598,380
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	47,743	26,868
<b>Gjithsej pasuria afatshkurtër</b>	<b>933,388</b>	<b>896,169</b>

#### 3.3 Rreziku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut të likuiditetit nënkupton mirëmbajtjen e mjaftueshme të parave të gatshme, disponueshmërinë e fondeve nëpërmjet marrëveshjeve adekuate të kredisë në disponueshmëri dhe aftësia për të mbledhur në kohën e duhur, brenda afateve të përcaktuara shumë e caktuara për konsumatorët.

KRM "ÇABRATI" SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

Tabelat në vijim prezantojnë maturitetet e mbetura kontraktuale të pasurive dhe detyrimeve financiare të kompanisë. Tabelat janë përgatitur në bazë të rrjedhës së pa-skontuar të parave të pasivëve financiar.

	31 Dhjetor 2017			
	Qarkulluese		Joqarkulluese	
	Deri në 1 vit (Euro)	1 deri në 2 vite (Euro)	2 deri në 5vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
<b>Pasuri financiare</b>				
Llogaritë e arkëtueshme	227,467			
Parapagimet	11,714	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme - Qytetaret & Bizneset	646,464			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	47,743			
<b>Gjithsej pasuria afatshkurtër</b>	<b>933,388</b>	-	-	-
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarit e pagueshme dhe detyrimet tjera	91,946	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>91,946</b>	-	-	-
	31 Dhjetor 2016			
	Qarkulluese		Joqarkulluese	
	Deri në 1 vit (Euro)	1 deri në 2 vite (Euro)	2 deri në 5vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
<b>Pasuri financiare</b>				
Llogaritë e arkëtueshme	258,566			
Parapagimet	12,355	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme - Qytetaret & Bizneset	598,380			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	26,868			
<b>Gjithsej pasuria afatshkurtër</b>	<b>896,169</b>	-	-	-
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogarit e pagueshme dhe detyrimet tjera	190,004			
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>190,004</b>	-	-	-



## KRM “ÇABRATI” SH.A.

### SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### 3.4 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregjeve, për shembull normat e këmbimit valutor ose normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e kompanisë ose në vlerën e instrumenteve financiare në posedim të saj. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhohet dhe kontrollohet ekspozimi ndaj rrezikut të tregut përbrenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimet.

##### *Risku i këmbimit valutor*

Kompania nuk i ekspozohet ndonjë rreziku të shtuar të këmbimit valutor pasi që të gjitha transaksionet bëhen në Euro brenda Kosovës.

##### *Rrjedha e parasë dhe risku i normës së vlerës reale*

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera reale e rrjedhës së ardhshme të parasë nga instrumentet financiare do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Menaxhmenti i kompanisë kryesisht është përgjegjëse për monitorimin ditor të pozicionit të rrezikut të normës neto të interesit dhe vendos kufijtë për të reduktuar potencialin për mospërputhje në normat e interesit. Nuk ka mbajtje interesi për fondet e huazuara nga institucionet financiare vendore apo të huaja në datën e pozicionit financiar.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>Pasuria</b>		
Me norma të ndryshme të interesit		
Bilancet bankare	47,743	26,868
<b>Total</b>	<b>47,743</b>	<b>26,868</b>

KRM "ÇABRATI" SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

4. Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë:

	Toka	Ndërtesat	Mjete dhe Paisje	Vetura	Total
<i>Kosto Historike</i>					
<b>Me 1 Janar 2016</b>	-	-	59,771	522,996	582,767
Shtesat	2,110,000	1,905	-	5,239	2,117,144
Heqjet					
<b>Me 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,110,000</b>	<b>1,905</b>	<b>59,771</b>	<b>528,235</b>	<b>2,699,912</b>
Shtesat					
Heqjet			(29,965)	(32,274)	(62,239)
<b>Me 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,110,000</b>	<b>1,905</b>	<b>29,806</b>	<b>495,961</b>	<b>2,637,673</b>
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>					
<b>Me 1 janar 2016</b>		-	38,266	388,828	427,093
Zhvlerësimi vitit		95	3,167	56,303	59,565
<b>Me 31 dhjetor 2016</b>		<b>95</b>	<b>41,432</b>	<b>445,131</b>	<b>486,658</b>
Zhvlerësimi vitit		95	3,167	41,168	44,430
Heqjet dhe rregullimi			(19,279)	(42,598)	(61,877)
<b>Me 31 dhjetor 2017</b>		<b>190</b>	<b>25,320</b>	<b>443,701</b>	<b>469,211</b>
<i>Vlera neto në Libra</i>					
<b>Me 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,110,000</b>	<b>1,810</b>	<b>18,339</b>	<b>83,104</b>	<b>2,213,258</b>
<b>Me 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,110,000</b>	<b>1,715</b>	<b>4,486</b>	<b>52,260</b>	<b>2,168,461</b>

Gjatë vitit 2016 Kompania ka njohur prona në vlerë prej 2,110,000 Euro (toka në Fierzë 3ha, 17 ari dhe 13m<sup>2</sup> me vlerë 950,000 Euro dhe toka në qendër 44.77 ari në vlerë prej 1,160,000 Euro) të cilat më herët nuk kanë qenë të prezentuara në pasqyra financiare. Këto toka janë në pronësi të Kompanisë së ashtu siç dëshmohet me shënimet kadastrale. Pronësia mbi tokën në Fierzë është kontestuar nga Agjencioni i Privatizimit të Kosovës dhe Kompania e ka të hapur këtë çështje gjyqësore.

**KRM “ÇABRATI” SH.A.****SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**

(të gjitha shumat janë në Euro)

**5. Llogaritë e arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqesin obligimet e klientëve të Bizneseve të mëdha dhe Institucioneve publike:

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Llogarite e arkëtueshme tregtare	227,467	258,566
<b>Gjithsej</b>	<b>227,467</b>	<b>258,566</b>

**6. Parapagimet**

Parapagimet për të punësuarit janë avanse të paguara në emër të pagave të punonjësve:

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Parapagimet	11,714	12,335
<b>Gjithsej</b>	<b>11,714</b>	<b>12,335</b>

**7. Llogari të arkëtueshme - Qytetaret & Bizneset e vogla**

Llogari të arkëtueshme - Qytetaret & bizneset e vogla me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqesin obligimet e klientëve të Amvisëris, Bizneseve të Vogla dhe nga klientët tjerë.

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Investimet ne letra me vlere	663,365	<b>672,417</b>
Shpenzimet e borxheve te keqija (Shënimi 18)	(16,901)	(74,037)
<b>Gjithsej</b>	<b>646,464</b>	598,380

**8. Paraja dhe ekuivalentët e parasë së gatshme**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë së gatshme me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 është:

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
<b>Paraja ne banke</b>		
NLB	385	-
BKT	-	15,338
PCB	16,397	8,248
RBKO	4,550	425
BANKA EKONOMIKE	8,767	1,648
TEB	17,069	799
BE Investive	251	251
BE Subvencione	18	18
<b>Paraja ne arkë</b>		
Arka	306	140
<b>Gjithsej</b>	<b>47,743</b>	<b>26,868</b>

**KRM “ÇABRATI” SH.A.****SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**

(të gjitha shumat janë në Euro)

**9. Llogaritë e pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqesin obligimet e kompanisë ndaj furnitorëve dhe janë:

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
KLMC	10,052	30,346
Syri Vizion	1,000	1,000
Mentori P	909	-
DHF Company	8,961	-
Llogaritë tjera të pagueshme	9,550	41,760
<b>Gjithsej</b>	<b>30,472</b>	<b>73,105</b>

**10. Obligimet për paga, tatime dhe kontribute**

Obligimet për paga, tatime dhe kontribute me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqesin obligimet e kompanisë ndaj Administratës Tatimore për tatimin në paga dhe kontribute për vitet e kaluara dhe janë:

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Obligimet per tatime dhe kontribute ne paga	51,368	80,930
<b>Gjithsej</b>	<b>51,368</b>	<b>80,930</b>

**11. Obligimet per tatim në fitim**

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Obligimet per tatimin ne fitim	7,274	17,817
<b>Gjithsej</b>	<b>7,274</b>	<b>17,817</b>

**12. TVSH e pagueshme**

TVSH e pagueshme me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqesin obligimet e kompanisë ndaj Administratës Tatimore për Tatimin mbi vlerën e shtuar dhe janë:

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
TVSH e pagueshme	2,833	18,151
<b>Gjithsej</b>	<b>2,833</b>	<b>18,151</b>

**KRM “ÇABRATI” SH.A.****SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**

(të gjitha shumat janë në Euro)

**13. Të hyrat nga shërbimet**

Të hyrat nga shërbimet për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqesin të hyrat nga shërbimet. Për vitin 2017 të hyrat janë të njohura duke respektuar parimin akrual ku janë njohur në bazë të faturimit dhe janë:

<b>Per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Të hyrat nga amvisëria	555,331	542,728
Të hyrat nga bizneset e vogla	117,058	116,388
Të hyrat nga bizneset e medha	-	-
Të hyrat nga institucionet	228,653	208,951
Të tjera	-	48,477
Të hyrat nga vitet paraprake	72,083	77,674
<b>Gjithsej</b>	<b>973,123</b>	<b>994,219</b>

**14. Shpenzimet e materialit**

Shpenzimet e materialit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë:

<b>Per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Shpenzimet e materialit ndihmes	8,130	10,904
Shpenzimet e materialit tjetër	-	-
Shpenzimet e materialit për zyre	4,200	5,674
Shpenzimet e materialit për higjiene	590	454
Shpenzimet e energjise elektrike	9,629	8,202
Shpenzimet e karburantit për auto	82,288	77,553
Shpenzimet e karburantit Benzina	2,514	1,498
Shpenzimet e vajrave motorike	4,739	4,811
Shpenzimet e Gazit - Plinit	176	131
<b>Gjithsej</b>	<b>112,266</b>	<b>109,228</b>

**15. Shpenzimet e pagave**

Shpenzimet e pagave për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë:

<b>Per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Shpenzimet e pagave neto	494,516	444,045
Shpenzimet e tatimeve ne paga	23,000	20,009
Shpenzimet e kontributeve ne Paga	54,378	48,847
<b>Gjithsej</b>	<b>571,894</b>	<b>512,902</b>

**KRM “ÇABRATI” SH.A.****SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016**

(të gjitha shumat janë në Euro)

**16. Shpenzimet tjera**

Shpenzimet tjera për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë:

<b>Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Shpenzimet te ndermjetme	1,472	3,425
Shpenzime per sherbime komunale	2,498	1,914
Autogoma	10,454	16,034
Shpenzime per sherbime te telefonit	4,362	4,840
Shpenzime per sherbime te tjera	85	0
Shpenzime te tjera	36,936	43,713
Shpenzimet e deponise - Mbeturinave	61,162	103,150
<b>Gjithsej</b>	<b>116,969</b>	<b>173,077</b>

**17. Shpenzimet tjera afariste**

Shpenzimet tjera afariste për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë:

<b>Per vitin që përfundon me 31 Dhjetor</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Shpenzimet e udhetimeve zyrtare	666	2,552
Shpenzimet per revista dhe publikime	2,574	2,345
Shpenzimet e perfaqesimit	4,463	3,129
Shpenzimet per premi te sigurimit	5,140	3,964
Shpenzimet per sigurim te tenderit	146	0
Shpenzimet per siguri te objektit	-	327
Shpenzimet tjera per premi	3,601	3,055
Shpenzimet e qarkullimit te pages	1,554	1,414
Shpenzimet e kuotave te anetaresis	1,510	1,899
Shpenzimet e tatimit te pasurise	641	549
Shpenzimet gjyqesore	1,586	1,932
Shpenzimet e sherbimeve mjekesore	3,747	83
Shpenzimet e perrnbaruesit	624	1,368
Shpenzimet e borxheve të vjetra për Tatim	6,527	-
Të tjera	267	-
<b>Gjithsej</b>	<b>33,044</b>	<b>22,615</b>

## KRM "ÇABRATI" SH.A.

### SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016

(të gjitha shumat janë në Euro)

#### 18. Shpenzimet e borxheve të këqija

Shpenzimet e borxheve të këqija për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqesin lejimet për borxhet e këqija gjatë viteve respektive. Menaxhmenti ka përdorur një politikë për provizionimin e borxheve të këqija duke përzgjedhur klientët të cilët nuk kanë bërë pagesa gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, vetëm borxhet e viteve 2014, 2015 dhe 2016 janë njohur si shpenzime:

Per vitin qe përfundon me 31 Dhjetor	2017	2016
Shpenzimet e borxheve të këqija	16,901	74,037
<b>Gjithsej</b>	<b>16,901</b>	<b>74,037</b>

#### 19. Të hyrat tjera

Të hyrat tjera paraqesin shitjet e paisjeve të Kompanisë dhe nuk paraqesin shitjet normale të biznesit. Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017 shitjet ishin në vlerë prej 20,235 Euro.

#### 20. Tatimi ne fitim i Korporatave

Për vitin që përfundon me	31 dhjetor 2017
Fitimi kontabël për vitin	97,854
Pagesat për tatime të viteve të kaluara	(3,131)
<b>Fitimi i tatueshëm 10%</b>	<b>94,723</b>
<b>Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat</b>	<b>9,472</b>
Pagesat e kryera	(2,198)
<b>Obligimi për tatim</b>	<b>7,274</b>

#### 21. Detyrimet kontingjente dhe zotimet

Me 31 dhjetor 2017 nuk ka detyrime kontingjente të cila kërkojnë shpalesje në pasqyrat financiare të kompanisë (me 31 dhjetor 2016: zero).

#### *Çështjet e hapura gjyqësore*

Ashtu siç është shpalosur në shënimin 6 të pasqyrave financiare, Kompania është në kontest gjyqësor e Agjencionin e Privatizimit të Kosovë (AKP) për tokenë në Fierzë. Deri në datën e raportit të auditimit, gjykata nuk ka sjellur ndonjë vendim prandaj dëshmi të mjaftueshme lidhur me efektin financiar në pasqyrat financiare.

#### 22. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje pasuese domethënëse pas datës së raportimit të cilat kërkojnë korrigjim ose shpalesje të pasqyrave financiare.